



Prishtinë, 10 maj 2017  
Kodi i ZRRE-së: V\_919\_2017

### Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

#### Duke u bazuar në:

- Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, nenin 25, nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-184);
- Nenin 19 të Rregullës për procedurën e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja;
- Vendimit mbi Njoftimin për Autorizim Preliminar V-558-2013 të datës 06 shtator 2013;
- Vendimin mbi Pranimin në Skemën Mbështetëse V-683-2015 të datës 20 shkurt 2015;
- Vendimin për lëshimin e Autorizimit Final V-755-2016 të datës 28 janar 2016 lëshuar shoqërisë "Hidroenergji" Sh.p.k., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lumin Lepenc për HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 8.5 MW, ZK Sllatinë, komuna e Kaçanikut;
- Kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final V-755-2016 të datës 28 janar 2016 për ndryshimin e kapacitetit instalues të hidrocentralit në Lumin Lepenc, HC Lepenci 3 nga kapaciteti instalues prej 8.5 MW në kapacitetin instalues prej 9.998 MW ZK Sllatinë, Komuna e Kaçanikut, të datës 28.04.2017 të shoqërisë "Hidroenergji" Sh.p.k., me adresë rruga "Dëshmorët e kombit" p.n. Ferizaj, Republika e Kosovës; dhe
- Vendimin nr. 3753-3/16 –ZSP- 521/2017 dt. 26.04.2017 për Lejimin e ndryshimit të vendimit mbi vazhdimin e lejes ujore nr. 3684/12 –ZSP- 70/13, të datës 17.01.2013, vetëm në rritjen e kapacitet instalues prej N= 8.5 MW në N= 9.998 MW në segmentin lumor nga Kuota Z= 706.80m.l.m e veprës së marrjes, deri në Kuota Z= 567.5 m.l.m. ndërtesa e HC Lepenci 3, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor; dhe
- Kontratat lejet, pëlqimet dhe vendimet e lëshuara nga institucionet përgjegjëse,

në seancën e mbajtur me datë 10 maj 2017 nxori këtë:

## V E N D I M PËR MODIFIKIM TË AUTORIZIMIT FINAL

- I lëshohet **VENDIMI PËR MODIFIKIMIN E AUTORIZIMIT FINAL V-755-2016** i datës 28 janar 2016, shoqërisë "Hidroenergji" Sh.p.k., për Hidrocentralin në Lumin Lepenc, **HC Lepenci 3** nga kapaciteti instalues prej **8.5 MW** në kapacitetin total instalues prej **9.998 MW**, sipas Vendimin nr. 3753-3/16 –ZSP- 521/2017 dt. 26.04.2017 për Lejimin e ndryshimit të vendimit mbi vazhdimin e lejes ujore nr. 3684/12 –ZSP- 70/13, të datës 17.01.2013, vetëm në rritjen e kapacitet instalues prej N= 8.5 MW në N= 9.998 MW në segmentin lumor nga Kuota Z= 706.80 m.l.m e veprës së marrjes, deri në Kuota Z= 567.5 m.l.m. ndërtesa e HC Lepenci 3, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH).



- II. **Obligohet** shoqëria “Hidroenergji” Sh.p.k, që pas Pranimit Teknik të HC “Lepenci 3”, të sjell Certifikatën e Përdorimit të lëshuar nga Organi kompetent i Komunës së Kaçanikut, dhe Lejen për Shfrytëzim Ujor të lëshuar nga MMPH.
- III. Pas finalizimit të projektit sipas dispozitivit nën pikën II. të këtij vendimi, Hidrocentrali HC Lepenci 3, do të hyn në Operim komercial sipas Marrëveshjes për Shitblerje të Energjisë Elektrike me Operatorin e Tregut(KOSTT) në kohëzgjatje 10 (dhjetë) vjeçare, me tarifën nxitëse të përcaktuar me vendimin nr. V-810-2016, të datës 19 maj 2016, të lëshuar nga Bordi i ZRRE-së, brenda tridhjetë (30) ditësh pas pranimit të certifikatës së përdorimit të lëshuar nga organi kompetent.
- IV. Shoqëria “Hidroenergji” Sh.p.k, obligohet që të pajiset me Leje Mjedisore (Ekologjike) të lëshuar nga MMPH.

### Arsyetim

- ZRRE me datë 03.06.2013 nga shoqëria “Hidroenergji” SH.P.K., ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali, në Lumin Lepenc, HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 8.5 MW ZK Sllatinë, komuna e Kaçanikut.
- ZRRE pas konstatimit se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga Hidrocentrali, me datë 06 shtator 2013 ka lëshuar Vendimin mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar V\_558\_2013, dhe ka udhëzuar aplikuesin që t'i plotësoj kërkesat tjera ligjore që kërkohen me legjislacionin në fuqi në Republikën e Kosovës.
- ZRRE me datë 15 korrik 2015 nga shoqëria “Hidroenergji” Sh.p.k, ka pranuar kërkesën për shndërrimin e Vendimit mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar në Autorizim Final për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lumin Lepenc për HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 8.5 MW, ZK Sllatinë, komuna e Kaçanikut, duke i bashkangjitur dëshmitë e lëshuara nga autoritetet relevante për përmbushjen e të gjitha kërkesave mjedisore, të drejtën mbi shfrytëzimin e tokës, të drejtat mbi shfrytëzimin e ujit, Lejen ndërtimore dhe kërkesat e tjera ligjore që lidhen me natyrën e projektit sipas legjislacionit në fuqi.
- ZRRE me datë 28 janar 2016 ka lëshuar Vendimin për Autorizimin Final V-755-2016 shoqërisë “Hidroenergji” Sh.p.k, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjenerues për prodhimin e energjisë elektrike nga Hidrocentrali në Lumin Lepenc për HC Lepenci 3 me kapacitet të instaluar prej 8.5 MW, ZK Sllatinë, komuna e Kaçanikut.
- ZRRE me datë 28 prill 2017 nga shoqëria “Hidroenergji” Sh.p.k, ka pranuar kërkesën për Modifikimin të Autorizimit Final për ndryshimin vetëm të kapacitetit instalues të Hidrocentralit në Lumin Lepenc, HC Lepenci 3 nga kapaciteti instalues prej **8.5 MW** në kapacitetin instalues prej **9.998 MW** ZK Sllatinë, Komuna e Kaçanikut.
- ZRRE ka pranuar s’ bashku me kërkesës për Modifikim të Autorizimit Final: Vendimin nr. 3753-3/16 –ZSP- 521/2017 dt. 26.04.2017 për Lejimin e ndryshimit të vendimit nr. 3684/12 –ZSP-70/13, vetëm në rritjen e kapacitet instalues prej N= 8.5 MW në N= 9.998 MW në segmentin





lumor nga Kuota Z= 706.80m.l.m e veprës së marrjes , deri në Kuota Z= 567.5 m.l.m. ndërtesa e HC Lepenci 3, e lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), kontratën për furnizim me turbina, dokumentacionin tekniko – investiv (ndryshimi HC Lepenci 3 nga N=8.5 MW në N=9.998 M dhe projektin e fizibilitetit final.

- ZRRE, pas vlerësimit të kërkesës për Modifikim të Autorizimit dhe dëshmime të bashkangjitura ka vlerësuar ato, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.

VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

**Vendimi iu dërgohet:**

- Palës,
- Komunës së Kaçanikut
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPH-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së

**Bordi i ZRRE-së:**

  
Krenar Bujupi, U.D kryesues

  
Arsim Janova, anëtar

  
Besim Sejfiqaj, anëtar